



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Me qëllim të sqarimit të mënyrës së zbatimit të Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-Vizuele, KPM-2013/03, Komisioni i Pavarur për Media paraqet këtë:

Memo sqaruese

Në mbështetje të Nenit 3.2.6 të Ligjit të Komisionit të Pavarur për Media (KPM) nr. 04/L-44, më 28 maj 2013 KPM ka miratuar Rregulloren KPM 2013/03 për Komunikimet Komerciale Audio-vizuele e cila shfuqizon Rregulloren KPM 2009/04. Kjo rregullore është harmonizuar dhe plotësuar sipas Ligjit të ri për KPM-në (04/L-44) dhe standardeve të përcaktuara me Direktivën e Shërbimeve Mediale Audio-vizuele (AVMS) dhe është paraparë të hyjë në fuqi 3 muaj pas nënshkrimit të saj.

Me këtë rregullore përcaktohen parimet themelore të komunikimeve komerciale audio-vizuele për transmetimin e tyre nga ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuele. Prej datës 28 gusht 2013 të gjithë shërbyesit medial audio-vizuel janë të obliguar të veprojnë në përputhje të plotë me Rregullorën KPM 2013/03.

Me nenin 10 të Rregullorës për Komunikime Komerciale, janë paraparë edhe limitet e kohëzgjatjes të reklamimit televiziv brenda një ore, që për transmetuesit televiziv komerciale është paraparë se nuk duhet të kalojë 12 minuta për orë, me përjashtim të dritareve të teleshopingut, ndërsa për transmetuesit publik televiziv nuk duhet të kalohen 4 minuta për orë me përjashtim të dritareve të teleshopingut.

Mirëpo, me nenin 17 të ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës është paraparë që transmetuesi publik, mund të emitojë porosi publicitare, reklama dhe marketing, deri në masën që nuk e rrezikon misionin dhe vizionin zhvillimor të tij, jo më shumë se dhjetë përqind (10%) të vëllimit programor të tërësishëm. Ky limit do të rishikohet në momentin e financimit nga parapagimi në pajtim me Ligjin për KPM-në.

Prandaj, deri në momentin e sigurimit të financimit nga parapagimi, transmetuesit publik do të emitojnë komunikime komerciale siç parashihet me nenin 17 të ligjit për Transmetuesin Publik. Neni 10 i Rregullorës për Komunikime Komerciale Audio-Vizuele KPM 2013/03 do të jetë i zbatueshëm për transmetuesit publik pas kalimit të kësaj periudhe (sigurimit të financimit nga parapagimi).